



EDUKIMI I VAZHDUAR PËR PROFESIONIN E INFERMIEREVE NË KEBEK

Standarte profesionale

Septembre 2011



Ordre
des infirmières
et infirmiers
du Québec

EDUKIMI I VAZHDUAR
PËR PROFESIONIN
E INFERMIEREVE NË KEBEK
Shtator 2011

Botimi

Koordinimi

Suzanne Durand, inf., M. shk. inf., D.E.S.S¹. në bioetik

Drejtoreshë, Drejtimi, zhvillimi dhe mbështetja profesionale e Urdhrit të infermiereve dhe infermierëve të Kebekut

Shkruar nga

Jérôme Ouellet, inf., M. A. (c.) (edukim, orientim, kërkim), Infermiere-këshilltare

Suzanne Durand, inf., M. Shk. inf., D.E.S.S. en bioetik, Drejtoreshë

Martine Maillé, inf., M. Sc. (administration), Infermiere-këshilluese

Drejtimi, zhvillimi dhe mbështetja e Urdhrit të infermiereve dhe infermierëve të Kebekut

Bashkëpunuan

Céline Thibault, M. A. Në inf.

Prodhimi

Shërbimi i publikimeve

Sylvie Couture, Shërbim dhe shërbim

Claire Demers, Ndihmës botues

Drejtoresha e shërbimeve për klientët dhe promovimin UIIK

Konceptimi dhe realizimi grafik

Grupi Flexidée

Redaktimi gjuhësor

Odette Lord

Korrektimi

Jocelyne Tétreault

Shpërndarja

Urdhri i infermiereve dhe infermiereve të Kebekut

Shitja e publikimeve

4200, boulevard Dorchester Ouest

Westmount (Québec) H3Z 1V4

Telefon : 514 935-2501 ou 1 800 363-6048

Fax : 514 935-3770

ventepublications@oiiq.org

www.oiiq.org

¹ D.E.S.S.- Diplômé e Studimeve të Larta të Specializuara (DSL)

Depozitimi légal

Biblioteka dhe Arkivat Kanada, 2011

Biblioteka dhe Arkivat kombëtare të Kebeku, 2011

ISBN 978-2-89229-543-6 (version i shtypur)

ISBN 978-2-89229-544-3 (PDF)

© Urdhri i infermiereve dhe infermiereve të Kebekut, 2011

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Shënim – Në përshtatje me politikën redaksionale të UIIK, gjinia femërore përdoret vetëm për të lehtësuar prezantimin.

HYRJE

Qysh prej disa vjetësh, edukimi i vazhduar zë një vend në plan të parë të temave të interesit si për anëtarët ashtu edhe për drejtuesit e urdhrave të ndryshme profesionale dhe kjo në një perspektivë të mbrojtjes së publikut dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Urdhri i infermiereve dhe infermierëve të Kebekut (UIIK) merret edhe me këtë çështje për infermieret që ushtrojnë profesionin në Kebek. Në këtë këndvështrim u miratuan një dokument orientues si dhe një normë profesionale që të organizojnë edukimin e vazhduar. Kjo normë profesionale buron nga dokumenti orientues i titulluar *Drejt një kulture të edukimit të vazhduar për infermieret dhe infermierët e Kebekut* dhe qartëson cilat janë disa elemente të zbatimit të saj.

ELEMENTE TË NORMËS PROFESIONALE

Norma profesionale e edukimit të vazhduar e miratuar nga UIIK saktëson se çfarë pritet nga infermieret në fushën e edukimit të vazhduar. Norma mbështet nenet 17 dhe 18 të Kodit të deontologjisë së infermiereve dhe infermierëve dhe shkrimeve që përshkruajnë ushtrimin e profesionit. Infermierja ka pra përgjegjësinë për t'iu përshtatur kësaj norme. TABELA 1 shpreh elementet e normës profesionale të zbatueshme për infermieret.

TABELA 1

Elementet e normës profesionale

Cdo infermiere duhet:	
Elementi 1	Të marrë pjesë në një minimum prej 20 orë veprimtarish të edukimit të vazhduar në vit duke filluar që nga 1 janari 2012: që përmbajnë të paktën 7 orë veprimtari të akredituara.
Elementi 2	Të deklarosh çdo vit, gjatë një regjistrimi në Tabelë, numrin e të gjitha orëve të veprimtarive të edukimit të vazhduar të realizuara dhe ndërmjet tyre, numrin e orëve të akredituara.
Elementi 3	Të mbash një regjistër vjetor të veprimtarive të edukimit të vazhduar dhe ta ruash atë gjatë pesë vjetësh.

ZBATIMI I ELEMENTEVE TË NORMËS PROFESIONALE

Norma profesionale përmban tri elementet e mëposhtme:

1. Duke filluar nga 1 janari 2012

Infermierja merr pjesë minimalisht në 20 orë veprimtari të edukimit të vazhduar në vit, që përmbajnë 7 orë veprimtari të akredituara.

Me qëllim që të zbatohet norma, periudha e referencës për deklarimin e numrit të orëve të veprimtarive të edukimit të vazhduar nga infermierja, shtrihet nga 1 janari deri në 31 dhjetor çdo vit për regjistrimin në Tabelën që kryhet jo më vonë se 31 marsi i ardhshëm. Për shembull, për një regjistrim në Tabelë që duhet të bëhet para 31 marsit 2013, infermierja deklaron numrin e të gjitha orëve të veprimtarive të edukimit të

vazhduar të realizuara nga 1 janari 2012 deri në 31 dhjetor 2012 dhe saktëson ndërmjet tyre numrin e orëve të veprimtarive të akredituara.

TABELA 2

Ndarja e orëve të edukimit të vazhduar për një periudhë njëvjeçare.

Per një periudhë njëvjeçare	Duke filluar nga 1 janari 2012
Oret minimale te veprimtarive te akredituara ose te veprimtarive te edukimit te vazhduar te UIIK	7
Totali i oreve te veprimtarive te edukimit te vazhduar	20

Le të nënvizojmë se :

- Numri i orëve të edukimit të vazhduar është i njëjtë për një infermiere që punon me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme;
- Numri i orëve të grumbulluara gjatë një periudhe të referencës (nga 1 janari deri në 31 dhjetor) mund ta kalojë numrin e orëve të vendosura nga norma profesionale;
- Numri i orëve të veprimtarive të edukimit të vazhduar të akredituara të cilat deklarohen mund të jetë më i madh se numri minimal i orëve të veprimtarive të edukimit të vazhduar të akredituara të vendosura nga norma profesionale.
- Orët e veprimtarive të edukimit të vazhduar që e kalojnë normën profesionale nuk mund t'i kalojnë periudhës së referencës që vijon:
- Infermieret praktikante të specializuara duhet të ndjekin 80 orë të edukimit të vazhduar në dy vite si shkruhet në dokumentin e titulluar *Udhëzime mbi modalitetet e praktikës së infermieres praktikante të specializuar* (2006).

Tipat e veprimtarive të edukimit të vazhduar të pranueshme për t'iu përshtatur normës:

Veprimtaritë e edukimit të vazhduar në të cilat merr pjesë infermierja duhet të jenë të rëndësishme për praktikën e saj profesionale. Ato duhet të lejojnë aktualizimin ose zhvillimin e kompetencave që lidhen me përkujdesjet infermierike ose kompetencat transversale në ushtrimin e funksioneve të saj.

Infermierja duhet të marrë pjesë në veprimtari të edukimit të vazhduar që bëjnë pjesë në tipat e veprimtarive të mëposhtme:

- a. Edukim i ofruar nga një institucion arsimor i mesëm ose universitar (pas edukimit fillestar)
- b. Veprimtari të edukimit të vazhduar të zhvilluara nga UIIK.
- c. Veprimtari të edukimit të vazhduar të organizuara nga një punëdhënës.
- d. Edukim i ofruar nga një grupim, një shoqatë profesionale ose nga një ekspert i njohur në një fushë të specializuar.
- e. Pjesëmarrje në konferenca, kolokiume, komitete shkencore në një mjedis klinik², kongrese, atelie ose seminare.
- f. Lexim artikujsh profesionalë dhe shkencorë, diskutime mbi studime rasti dhe klub leximi.
- g. Përgatitje e një prezantimi në kuadrin e një konference.
- h. Shkrimi (dhe publikimi) i artikujve dhe e veprave të rëndësishme për përkujdesjet infermierike

² shembull : Komiteti i farmacisë ose komiteti mbi praktikat shembullore të përkujdesjeve

Ndërmjet 20 orëve të edukimit të vazhduar që ajo ndjek, infermierja merr pjesë të paktën në 7 orë veprimtari të edukimit të akredituara ose veprimtari të edukimit të vazhduar të UIIK.

Karakteristikat e edukimit të pranueshme për orët e edukimit të akredituara janë:

- Veprimtaritë e edukimit të vazhduar të zhvilluara nga UIIK, organizëm përgjegjës për të nxjerrë standarde të profesionit të infermierit;
- Veprimtaritë e edukimit të njohura nga organizmat e autorizuar për të lëshuar ose dhënë, për shembull një certifikatë, kredite edukimi (që çojnë në marrjen e një vërtetimi ose një diplome), kredite për edukimin e vazhduar, kredite të edukimit mjekësor (KEM) ose kredite të edukimit të vazhduar (KEV)

Shembuj veprimtarish edukimi të pranueshme për orët e edukimit të akredituara

- Leksione universitare pas edukimit fillestar
- Veprimtaritë e edukimit të vazhduar të zhvilluara nga UIIK (përfshi ato që rimerren nga urdhrat rajonalë)
- Veprimtaritë e vetëedukimit me vlerësim certifikues të proceseve mësimore (p.sh. të mësuarit në linjë)
- ACLS (Advanced Cardiac Life Support)
- Certifikatë në rianimacionin kardiorespirator (RCR) e lëshuar nga Fondacioni i sëmundjeve të zemrës.
- Certifikatë si këshilluese në ushqyerjen me gji (International Board of Certified Lactation Consultant)
- Veprimtaritë e edukimit të vazhduar që futen në programin AMPROOB
- Certifikatë kombëtare e Shoqatës së infermiereve dhe infermierëve të Kanadasë

2. Infermierja deklaron çdo vit, në momentin e regjistrimit të saj në Tabelë, numrin e orëve që i ka kushtuar veprimtarive të edukimit të vazhduar dhe ndërmjet tyre numrin e orëve të veprimtarive të edukimit të akredituara.

Deklarimi i shumës së orëve të edukimit të vazhduar të realizuara gjatë vitit bëhet, duke filluar nga 1 janari 2012, një normë profesionale e zbatueshme për çdo infermiere. Para 31 marsit 2013, infermierja tregon çdo vit numrin e orëve që i ka kushtuar veprimtarive të edukimit të vazhduar gjatë vitit të fundit (nga 1 janari deri në 31 dhjetor), duke specifikuar ato që janë të akredituara. Ky deklaram bëhet në një regjistër që gjendet në portalin e edukimit të UIIK, në momentin e regjistrimit në Tabelën e anëtarëve.

Përfundim :

Gjatë regjistrimit në Tabelë, anëtari që nuk ka mundur të ndjekë apo respektojë normën profesionale gjatë periudhës së referencës duhet të jetë në gjendje të tregojë pse nuk ka mundur të marrë pjesë në veprimtaritë e edukimit të vazhduar për një nga motivet e mëposhtme:

- Të mungosh për arsye shëndetësore ose për ndërprerje të punës për më shumë se gjashtë muaj;
- Të jesh fshirë nga lista ose i pezulluar për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj;
- Të jesh me leje lindje ose me leje prindërore;
- Të deklaroj se je tërhequr nga profesioni i infermierit;
- Të ish i regjistruar në Tabelë qysh prej më pak se një vit;
- Të punosh jashtë Kebekut.

3. Infermierja mban një regjistër vjetor të veprimtarive të saj të edukimit të vazhduar dhe e ruan atë gjatë një periudhe pesëvjeçare.

Çdo infermiere është gjithashtu përgjegjëse për të përditësuar regjistrin e veprimtarive të edukimit të vazhduar, d.m.th. të deklarojë veprimtaritë e saj të edukimit, të llogarisë orët e saj të veprimtarive të akredituara ose të veprimtarive të tjera dhe të ruajë të gjitha vërtetimet (p. sh. : certifikata RCR, provë e pjesëmarrjes në një veprimtari të edukimit me ose pa marrjen e UEC-së ose dokumenteve të tjera të gjykuara të rëndësishme që dëshmojnë se ajo ka marrë pjesë në veprimtari të edukimit të vazhduar. Ajo duhet të jetë në gjendje të paraqesë në çdo kohë regjistrin e saj dhe vërtetimet e UIIK. Ky regjistër gjendet në portalin e edukimit të UIIK dhe mund të mbushet në linjë ose të shkarkohet.

Mekanizmat e ndjekjes dhe mbështetjes së UIIK

Megjithëse norma profesionale mbështetet kryesisht në përgjegjësinë profesionale dhe detyrën deontologjike të çdo infermiereje për të përditësuar kompetencat e saj, Urdhri mendon të vendosë mekanizma të ndjekjes dhe kontrollit të normës dhe të mbështetjes.

Duke filluar nga 1 prilli 2013, Urdhri do të ndërmarrë analizën e numrit të orëve që infermieret do të kenë deklaruar për periudhën njëvjeçare në zbatimin e normës profesionale. Nga ana tjetër, respektimi i kësaj norme do të bëjë pjesë tek elementet e verifikuara në kuadrin e inspektimit profesional.

Për më tepër, UIIK dëshiron të mbështesë infermieret në zhvillimin profesional duke ofruar një platformë të të mësuarit në linjë me qëllim që të kenë akses në veprimtaritë e edukimit të vazhduar në sajë të një repertori edukimi, një edukimi në linjë dhe një regjistri dixhital (numerik) të veprimtarive të realizuara të edukimit të vazhduar.

Përdorimi i Fondit të Trashëgimisë bën të mundur këto zhvillime që lehtësojnë aksesin në edukimin e vazhduar dhe nxisin përkrahjen e një kulture edukimi të vazhduar për të gjitha infermieret e Kebekut.